



Tiranë më

Nr.

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit.

Neni 25, pikat 12 dhe 13, të Kodit Zgjedhor parashikojnë se Rregullatori, me propozimin e Komisionerit, miraton aktet e nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste. Komisioneri dhe Ministri përgjegjës për gjendjen civile, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë me akt të përbashkët mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit.

Neni 46, pika 3 i Kodit Zgjedhor parashikon se lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Vendimi nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, u hartua në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave

që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend, me qëllim garantimin e të drejtës së votës të çdo shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve.

Për shkak të volumit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë (brenda 10 ditëve ka patur më shumë se 50,000 kërkesa, nga të cilat janë miratuar kërkesat e rreth 29,000 zgjedhësve), si dhe për të lehtësuar punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me qëllim që të fillojë punën përgatitore për të identifikuar këta zgjedhës të cilët në përfundim të procesit të regjistrimit do të jenë pjesë e listës së zgjedhësve nga jashtë dhe do të hiqen nga lista e zgjedhësve brenda vendit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj, 2025, lind nevoja e një parashikimi shtesë pas pikës 4 të kreut V. Në të kundërt, DPGjC do të merrte listën e shtetasve të cilave u është miratuar kërkesa për regjistrim vetëm përpara daljes së listës paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit (63 ditë përpara datës së zgjedhjeve), duke patur kështu shumë pak kohë në dispozicion për të kryer veprimet përkatëse teknike me qëllim gjenerimin e listës/ve në bazë qarku për votuesit nga jashtë si dhe për t'i hequr ata nga lista e zgjedhësve brenda vendit. Kjo do të mundësojë që ndërkohë edhe auditët teknikienë të emëruar sipas nenit 61 të Kodit Zgjedhor të mund të verifikojnë në kohë e me cilësi procesin e hartimit të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit dhe të reflektimit të ktyre ndryshimeve në ekstraktin e listës së zgjedhësve brenda vendit.

Propozohet që gjatë procesit të administrimit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, KQZ të vendosë në dispozicion të DPGjC-së, çdo ditë të Hënë, listën e shtetasve të cilëve iu është miratuar kërkesa për regjistrim. Kjo listë do të gjenerohet në mënyrë automatike nga Platforma Elektronike e Regjistrimit (PER) dhe do t'i vendoset në dispozicion DPGjC-së në format elektronik. DPGjC merr masa të hartojë dhe publikojë ekstraktin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim, brenda 24 orëve, sipas përbërësve të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të përcaktuar në këtë vendim.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Jona Josifi - Drejtoria e Votimit nga Jashtë

Pavlina DOÇAJ - Drejtoria e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pikat 12 dhe 13, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

I. Në tekstin e vendimit nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 4 të kreut V, shtohet pika me përmbajtjen si vijon:

“Gjatë procesit të administrimit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, KQZ i vë në dispozicion DPGjC-së, çdo ditë të Hënë, listën e shtetasve të cilëve iu është miratuar kërkesa për regjistrim. Kjo listë gjenerohet në mënyrë automatike nga Platforma Elektronike e Regjistrimit (PER) dhe i vendoset në dispozicion DPGjC-së në format elektronik. DPGjC merr masa të hartojë dhe publikojë ekstraktin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim, brenda 24 orëve, sipas përbërësve të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të përcaktuar në këtë vendim.”.

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për një shtesë në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”

- II. Ngarkohen administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar